



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 162 Prot

Shkodër, më 15 . 01 .2018

RELACION

Mbledhja e Senatit Akademik e datës 15.1.2018.

Senati Akademik (SA) i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", trajtoi disa çështje të rëndësishme në mbledhjen e tij të datës 15.01.2018 dhe morri vendimet përkatëse të mëposhtme:

1. Miratimin e Raportit të "Analizës së Treguesve të Proçesit Mësimor – Kërkimor për Vitin Akademik 2016- 2017 në Universitetin 'Luigj Gurakuqi' të Shkodrës".

Ky raport ishte punuar nga Prof.dr. Gezim Dibra (Kryetar) së bashku me Prof.as.dr. Jozef Bushati, Mrs. Jonida Lezha, Suzana Rahova. Pjesë e grupit të punës ishte i angazhuar gjithashtu Prof. Ilirian Malollari (Ekspert i Jashtëm). Relacioni ishte i strukturuar në këtë mënyrë:

- a. Misioni dhe objektivat për vitin 2017: si janë realizuar si fakultet apo si programe studimi
- b. Realizimi i programeve me cilësi, përditësimi i tyre. Hapja e programeve të reja dhe orientimi i tyre drejt tregut të punës.
- c. Format dhe metodat e përdorura në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies.
- d. Sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi i mësimdhënies (instrumentet e përdorur)
- e. Infrastruktura në shërbim të proçesit mësimor.
- f. Praktika brënda lëndës apo ajo profesionale
- g. Tabela e rezultateve.
- h. Analiza SWOT
- i. Drejtimet e punës mësimore për vitin mësimor 2017- 2018

Senatorët që ishin njohur më përpara me Raportin, ishin dakort në përgjithsi me pasqyrimin e punës mësimore për vitin akademik 2016-2017. U vunë në dukje disa drejtime për t'u përmirësuar cilësinë e raportit si: një analizë më e thellë e statistikave të raportuara; bërje më të plotë të analizës SWOT; lidhje me shumë e analizes së punës mësimore me strategjinë e USH. Gjithashtu u dhanë rekomandime për përmisime të problematikave të dala gjatë proçesit mësimor 2016-2017 si:



- Të bëhen rregullime institucionale për bërjen e praktikave profesionale: - për praktikat në bizneset të lidhet marrëveshje me zyren e Tatimeve që operon në zonat ku studentët mund të bëjnë praktiken; - për praktikat në institucionet arsimore të lidhet marrëveshje midis MARS dhe USH, ose të propozohet që praktika që kryejnë studentët para se të hyjnë në provimin e licënsimit të njihet si praktikë profesionale, e cila të mbikqyret nga pedagogu i caktuar. Pas kësaj studenti të diplomohet dhe të futet më pas në provimin e licënsimit.
 - Te funksionojne strukturat koordinuese e drejtuese të programeve Master sipas rregullores së programeve Master të USH dhe Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ne institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
 - Me rregullimin e faqes Web të USH, të shikohet mundësia që studentëve të mos i hapet sistemi për rregjistrimin në provim pa dhënë feedback-un e tyre për procesin mësimor dhe pedagogun e lëndës që do japin provim. Në këtë mënyrë kemi mundësi gjykimi më objektiv për performance e pedagogëve dhe cilësinë e procesit mësimor.
- Raporti i "Analizës së Treguesve të Procesit Mësimor – Kërkimor për Vitin Akademik 2016-2017 në USH 'Luigj Gurakuqi'" i bashkangjitet vendimit përkatës të SA.

2. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve të vitit të parë në programet studimore që ofron USH në ciklin e parë dhe te dyte te studimeve për vitin akademik 2018-2019, sipas propozimeve të derguara nga dekanatet e fakulteteve të USH, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ne institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 72 pika4; VKM nr.346 datë 19.04.2017 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018".

Të gjitha këto kriterë u miratuan unanimisht nga anëtarët e SA pjesmarrës në këtë mbledhje (16 anëtarë). Kriteret sipas degëve të bashkangjitura në Vendimin përkatës të Senatit Akademik të USH nr.19 datë 15.01.2018 do i pwrçillet MARS dhe QSHA.

3. Miratimin e kuotave të parashikuara për pranimet e studentëve në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të ofruara nga USH, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ne institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe propozimeve të dërguara nga dekanatet e fakulteteve të USH.

Të gjitha kuotat, e propozuara nga dekanatet e fakulteteve të USH, u miratuan unanimisht nga anëtarët e SA pjesmarrës në këtë mbledhje (16 anëtarë). Kuotat sipas programeve të çdo cikli studimi të ofruara nga USH i bashkangjiten Vendimit përkatës të Senatit Akademik të USH nr. datë 15.01.2018 dhe do i do i pwrçillet MARS.

4. Miratim për t'i propozuar Bordit të Administrimit që për anëtarët e SA të USH të dyfishohet pagesa e pjesmarrjes në mbledhje të SA.



5. Miratim për t'i propozuar Bordit të Administrimit që për anëtarët e Këshillit të Etikës të USH të paguhen si anëtarët e SA të USH, por vetëm deri në pesë mbledhje të marra pjesë.

Relacioni mbi mbledhjen e Senatit Akademik të USH-së të datës 15.01.2018 do të pasqyrohet në website të USH-së.

Sekretari i Senatit

Prof. as., dr. Mirjam Dibra

Kryetari i Senatit



Prof. dr. Adem Bektashi